



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

PROJEKTI QYTETAR KUNDËR KORRUPSIONIT

broshurë

Tiranë Dhjetor, 2015



Ky material eshte pjese e projektit qe mbeshtetet financiarisht nga Programi i Granteve te Vogla i Komisionit per Demokraci i Ambasades se SH.B.A. -se ne Tirane. Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura jane te autor-it/ve dhe nuk perfaqesojne domosdoshmerisht ato te Departamentit te Shtetit.



Partner institucional: Ministria e Arsimit dhe Sportit

Koordinator projekti: Shfqet Shyti
Ndihmoi në përgatitje: Besjana Kuci

Copyright IDM, Tiranë 2015



Përmbytja





HYRJE



KAPITULLI I: TË KUPTOJMË KORRUPSIONIN

*Konceptet kryesore
Llojet dhe format e ndryshme të korrupsionit
Shkaqet e korrupsionit
Pasojat e korrupsionit
Si matet korrupsioni?*



KAPITULLI II: ELEMENTËT E SISTEMIT KOMBËTAR TË INTEGRITETIT (NIS) NË SHQIPËRI

*Legjislativi
Ekzekutivi
Gjyqësori
Agjensitë e zbatimit të ligjit
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Avokati i Popullit
Kontrolli i Lartë i Shtetit
Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive
dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI)
Qeverisja Vendore
Media
Shoqëria civile
Sektori privat*



KAPITULLI III: PËRFSHIRJA E TË RINJVE NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

*Qasjet kundër korrupsionit
Format e veprimtarive ndërgjegjëse
Udhëzues për organizimin dhe zbatimin e veprimtarive*

Burime të Dobishme Informacioni

Referenca



Hyrje

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) me mbështetjen e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS) gjatë viteve 2013-2015 ka pilotuar me sukses “Projektin Qytetar Kundër Korrupsionit” me nxënësit e gjashtë shkollave të mesme në Tiranë (“Qemal Stafa”, “Petro Nini Luarasi” dhe “Myslym Keta”) dhe Elbasan (“Konstandin Kristoforidhi”, “Vasil Kamami” dhe “Ahmet Dakli”).

Në vazhdim të kësaj nisme, duke vlerësuar rëndësinë e edukimit dhe përfshirjes së brezit të ri në luftën kundër korrupsionit, edhe për vitin shkollor 2015-2016. Ambasada e SHBA-ve në bashkëpunim me MAS ka mbështetur zgjerimin dhe zbatimin e këtij projekti me nxënësit e shkollave të mesme në pesë bashkitë Shkodër, Kukës, Elbasan, Berat dhe Vlorë.

Në këtë kuadër IDM ka përgatitur këtë broshurë e cila trajton natyrën dhe kompleksitetin e problemit të korrupsionit dhe synon të shërbejë si instrument edukues duke ofruar informacion dhe burime për përgatitjen dhe implementimin e projekteve të cilët nxisin angazhimin e të rinjve në luftën kundër korrupsionit.

Broshura është e
organizuar në tre
kapituj kryesorë.

1

Kapitulli i parë paraqet një
vështrim të përgjithshëm mbi
fenomenin e korrupsionit dhe
mënyrat e matjes së tij.

2

Kapitulli i dytë përqendrohet
tek përshkrimi i rolit të
institucioneve kryesore në
Shqipëri për luftën kundër
korrupsionit duke u bazuar në
elementët e sistemit kombëtar
të Integritetit (NIS).

3

Kapitulli i tretë synon të nxisë
përfshirjen e të rinjve në
veprimtari konkrete kundër
korrupsionit.

1

Tä kuptojmä korrupsionin



Korrupsioni është një ndër problemet kryesore me të cilët përballen shumë vende, veçanërisht vendet në zhvillim dhe ato që sapo e kanë hedhur pas të shkuarën autoritariste ose totalitare. Sipas Organizatës së Kombeve të Bashkuara, korrupsioni minon institucionet demokratike, ngadalëson zhvillimin ekonomik dhe i bën qeveritë më pak të qëndrueshme; ndërsa Banka Botërore e ka përshkruar korrupsionin si një ndër pengesat më kryesore të zhvillimit ekonomik¹.

Përcaktimi i nivelit të korrupsionit në një vend është shumë i vështirë për t' u vlerësuar. Megjithatë, ka të dhëna të ndryshme që të çojnë në përfundimin e pranuar gjerësisht se Shqipëria vuan ende nga nivele të larta të korrupsionit në shumë fusha prandaj lufta kundër korrupsionit dhe arritja e rezultateve konkrete në këtë fushë është një nga prioritetet që qeveria shqiptare duhet të përmbushë në rrugën e anëtarësimit të vendit në Bashkimin Evropian.

Megjithatë, duhet patur parasysh që jo gjithçka që shihet si korrupsion nga opinionioni publik dhe media është me të vërtetë korrupsion. Ngjanjëherë, ekziston një perceptim i përciptë për arsyet, kushtet, pasojat e korrupsionit dhe rrugët për ta luftuar atë. Rrjedhimisht, është e rëndësishme që të thellohen njohuritë rreth korrupsionit për të qenë të suksesshëm në luftën kundër këtij fenomeni.

KONCEPTET KRYESORE

KORRUPSIONI

Përkufizimi i korrupsionit është një detyrë e vështirë. Ai është një fenomen kompleks që përfshin një gamë të gjerë praktikash, nga ryshfeti individual deri tek vjedhja apo shpërdorimi i madh i fondeve publike. Sipas Transparency International, korrupsioni përkufizohet si “abuzim me pushtetin e besuar për përfitime private”.²

1 *Project Against Corruption in Albania (PACA), Edukimi kundër korrupsionit: Manual për mësuesit, 2012*

2 <https://www.transparency.org/what-is-corruption/#define>



TRANSPARENCA

Transparenca mund të përkufizohet si një parim i cili bën të mundur që personat e prekur nga vendimet administrative, transaksionet e biznesit apo veprat e bamirësisë të njihen jo vetëm me faktet dhe shifrat por edhe me mekanizmat dhe proceset. Çdo qytetar duhet të përpiqet që transparenca të mizotërojë në të gjitha sferat e shoqërisë, si publike ashtu edhe private.³

LLOGARIDHËNIA

Llogaridhënia e personave apo institucioneve ekziston atëherë kur detyrat e tyre profesionale u “nënshtrohen mbikqyrjes, drejtimit apo kërkesës së të tjerëve për të dhënë informacion apo për të justifikuar veprimet e tyre.” Niveli i lartë i llogaridhënies dhe i transparencës i mbyll dyert praktika korruptive dhe ndihmon në minimizimin e mundësive për korrupsion.⁴

INTEGRITETI

Sjellje dhe veprime në përputhje me një tërësi parimesh e standardesh morale apo etike që zbatohen nga individët e institucionet dhe që pengojnë korrupsionin.⁵

Në formë ekuacioni, korrupsioni do të ishte i tillë:

$$K = P1 + P2 - LI$$

K=Korrupsion

P1=Përfitim

P2=Pushtet

LI=Llogaridhënie

Ekuacioni tregon se korrupsioni rritet kur rriten mundësia për përfitim dhe pushteti. Ndërsa, korrupsioni zvogëlohet kur individët japin llogari për veprimet e tyre.⁶

3 *Ibid*

4 *Ibid*

5 <https://www.transparency.org/glossary/term/integrity>

6 USAID, *Addressing corruption in education: A toolkit for youth from youth*, 2012, pg. 14.



LLOJET DHE FORMAT E NDRYSHME TË KORRUPSIONIT

Llojet kryesore të korrupsionit janë korrupsioni i vogël ose burokratik, korrupsioni i madh ose politik dhe kapja e shtetit. Ka shkaqe të ndryshme për lloje të ndryshme të korrupsionit: shkak i korrupsionit mund të jetë lakmia, nevoja, mundësia, mungesa e ndëshkimit, mungesa e hetimit ose mbikqyrjes, presioni i shokëve dhe zakoni.

»»» **Korrupsioni i vogël ose burokratik, administrativ** është korrupsioni i përditshëm. Ai ndodh në hallkën e fundit të implementimit të politikave, atje ku publiku takohet me nëpunësit publikë. Korrupsioni i vogël përshkruhet ndryshe si “korrupsioni i mbijetesës”, një lloj korrupsioni i cili bëhet zakonisht nga nëpunës të paguar jo mirë, të cilët varen nga pagesat shtesë për të ushqyer dhe strehuar familjet e tyre. Edhe pse korrupsioni i vogël përfshin shuma të vogla parash, këto shuma gjithsesi nuk janë të vogla për ata që i paguajnë. Korrupsioni i vogël sfidon pjesëtarët e shoqërisë që kanë të ardhura të ulëta dhe që duhet të paguajnë rregullisht ryshfet në kontaktet e tyre me administratën dhe shërbimet publike të tilla si policia, spitalet, etj.

»»» **Korrupsioni i madh i nivelit të lartë ose politik** ndodh aty ku hartohen politikat nga politikanët. Ai nuk ka të bëjë aq shumë me sasinë e parave që paguhet se sa me nivelin në të cilin ndodh – atje ku mund të ndikohet padrejtësisht mbi rregullat dhe politikat. Llojet e transaksioneve të cilat tërheqin korrupsionin e madh janë zakonisht të një shkalle të gjerë. Në disa raste termi “korrupsion politik” përdoret si sinonim i korrupsionit të madh të nivelit të lartë, duke iu referuar shpërdorimit që udhëheqësit politikë i bëjnë pushtetit që u është besuar. Në disa raste të tjera, korrupsioni politik i referohet në mënyrë të veçantë korrupsionit brenda proceseve politike dhe zgjedhore.

»»» **Kapja e shtetit** njihet si problemi korruptiv më shkatërrimtar dhe më i vështirë. Kapja e shtetit është një fenomen në të cilin interesat e jashtme (sektori privat, rrjetet mafioze, etj.) janë në gjendje të bëjnë ligjet, politikat dhe rregullat e shtetit për të siguruar përfitimet e veta përmes transaksioneve korruptive me nëpunës publikë dhe politikanë.



FORMAT E NDRYSHME TË KORRUPSIONIT

Korrupsioni është një problem që ekziston në të gjitha vendet, ndaj, për këtë arsye, të gjitha vendet duhet të forcojnë dhe përmirësojnë politikën, strategjitë, institucionet, kuadrin ligjor dhe përpjekjet konkrete të qëndrueshme për ta parandaluar dhe për ta luftuar atë. Disa nga krimet që lidhen me korrupsionin gjenden në të njëjtën kohë në legjislacionin e vendeve të ndryshme. Ndër to dallohen krime të tilla, si:

- Marrja, zhvatja ose dhënia e mitës.
- Menaxhimi i keq ose përvetësimi i pronave të shtetit.
- Përdorimi jo i ligjshëm i informacioneve shtetërore konfidenciale.
- Tregtia përmes ndikimit dhe përdorimi i saj për përfitime personale.
- Mashtrimi në zgjedhje dhe ndërhyrja në to.
- Përhapja e informacioneve të pasakta ose sigurimi i tyre për t'i çorientuar hetuesit.
- Pasurimi jo i ligjshëm.
- Pengimi ose ndërhyrja në urdhërat shtetërore.
- Dënimi i personave, të cilët informojnë për sjellje të pahijshme të zyrtarëve
- Dëmtimi i shërbimeve publike

Format kryesore të korrupsionit janë ryshfeti/mita, zhvatja, favoritizmi, përvetësimi, konflikti i interesit dhe mashtrimi. Ato ndodhin si në korrupsionin e vogël ashtu edhe në korrupsionin e madh. Por veprimet korruptive shkojnë përtej transaksioneve financiare prandaj korrupsioni shfaqet edhe në formën e transaksioneve jo financiare të tilla si nepotizmi, shfrytëzimi dhe abuzimi seksual, detyrimi dhe përfitimi politik ose shoqëror.

▶▶▶ **Ryshfeti** është akti i ofrimit të parave ose sendeve të tjera me vlerë me synimin për të bindur dikë të bëjë diçka për ju. Ryshfeti është korrupsion i mirfilltë. Ryshfeti klasifikohet si vepër penale në legjislacionin shqiptar dhe atë ndërkombëtar.

▶▶▶ **Zhvatja** është marrja ose dhënia e paligjshme e pronës ose parave përmes përdorimit të forcës ose kërcënimit. Një shembull tipik i zhvatjes do të ishte rasti kur policët ose ushtarakët e armatosur kërkojnë para për të lejuar kalimin në postbllok.



- ▶▶▶ **Favoritizmi** i referohet prirjes normale të njeriut për të preferuar të njohurit, miqtë dhe familiarët në krahasim me të panjohurit. Kjo nuk është gjithmonë një formë korrupsioni. Megjithatë, kur nëpunësit publikë (dhe ato të sektorit privat) shfaqin favoritizëm në shpërndarjen e padrejtë të burimeve dhe vendeve të punës, ata janë fajtorë për nepotizëm (të afërm) ose favoritizëm (miq e shokë) në varësi të lidhjes me personat e përfshirë.
- ▶▶▶ **Përvetësimi** është shpërdorimi i pronave apo fondeve të lëna në mirëbesim të dikujt për shkak të pozicionit të tij/saj formal si agjent apo kujdestar.
- ▶▶▶ **Konflikti i interesit** lind kur një individ i cili ka përgjegjësinë formale për t'i shërbyer publikut merr pjesë në një veprimtari që rrezikon gjykimin profesional, objektivitetin dhe pavarësinë e tij/saj. Shpesh një veprimtari e tillë (p.sh. biznes privat) i shërben pikë së pari interesave personale dhe mund të ndikojë në ushtrimin objektiv të detyrave zyrtare të këtij individi.
- ▶▶▶ **Mashtrimi** është krim ekonomik që përfshin gënjeshtër, hilenë ose pretendime të rreme me anë të të cilave dikush përfiton padrejtësisht. Mashtrimi motivohet nga dëshira për përfituar duke e gënjyer dikë tjetër dhe duke e dëmtuar atë.

SHKAQET E KORRUPSIONIT

Ndër shkaqet e korrupsionit mund të përfshihen sa më poshtë:

- Politikat ekonomike të papërshtatshme,
- Ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja e ulët e publikut,
- Dobësia e rolit të shoqërisë civile,
- Mungesa e llogaridhënies së institucioneve publike,
- Vullneti i dobët politik,
- Kultura apo mentaliteti i shoqërisë dhe traditat kombëtare,
- Niveli i lartë i informalitetit,
- Kultura e pandëshkueshmërisë.



PASOJAT E KORRUPSIONIT

PASOJAT NEGATIVE NË FUSHËN EKONOMIKE:

- Në shtetet e korruptuara, komuniteti i biznesit duhet të përdorë disa nga fondet e veta për qëllime korrupsioni, gjë që shkurton investimet dhe prodhimin kombëtar bruto.
- Korrupsioni i zë frymën konkurrencës së lirë, në mënyrë të veçantë kompanive të vogla.
- Me rënien e konkurrencës ullet edhe cilësia e mallrave dhe e shërbimeve.
- Ulen të ardhurat shtetërore dhe rritet ekonomia në hije (informale).
- Aty ku tolerohet korrupsioni, punonjësit civilë marrin të ardhura të vogla dhe mbi qytetarët e thjeshtë rëndon mita që ata duhet të paguajnë për zgjidhjen e problemeve të tyre.
- Investitorët e huaj kanë më pak besim tek shteti dhe, për këtë arsye, kontributi i tyre ndaj ekonomisë së vendit bie.

PASOJAT NË CILËSINË E QEVERISJES SË SHTETIT:

- Ulet numri i investimeve publike dhe efikasiteti i ndërmarrjeve shtetërore.
- Fushat e aktiviteteve qeveritare dhe strukturat e shpenzimeve i nënshtrohen ndryshimit pasi zyrtarët publikë të korruptuar "miratojnë" projekte të cilat u garantojnë atyre shuma më të mëdha.
- Egoizmi i zyrtarëve publikë lë në hije të menduarit strategjik për kuptimin e nevojave të shtetit, prandaj mungon vëmendja e duhur për problemet ekonomike dhe sociale.
- Ulet cilësia e shërbimeve publike.



PASOJAT SOCIO-POLITIKE:

- Mirëqenia personale gjithnjë e më shumë vlerësohet si më e rëndësishme se mirëqenia publike, e cila pothuajse lihet në harresë.
- Politikanët dhe nëpunësit civilë fillojnë të keqpërdorin pozitën e tyre për të krijuar mirëqenie personale.
- Të rinjtë i shohin shërbimet civile si një mënyrë jetese sa të përshtatshme, aq edhe tërheqëse.
- Shoqëria e korruptuar nuk arrin të shohë as motivet e luftës kundër korrupsionit. Vetë njerëzit nuk arrijnë të dallojnë nëse janë të pakënaqur me praninë e korrupsionit si të tillë, apo me faktin që dikush tjetër dhe jo ata ka siguruar përfitime të mëdha ose më të mëdha.
- Niveli i korrupsionit mund të lidhet me kulturën, mentalitetin dhe traditat e një shoqërie të caktuar. Në shoqëritë ku korrupsioni gati përligjet është shumë më e vështirë të ndryshohen veset e jetesës dhe të menduarit
- Punonjësit civilë mund të demoralizohen nga pagat e ulëta, nga përgjegjësitë e punës që nuk kanë të bëjnë me llojin dhe cilësinë e saj, nga qëllimet jo të qarta të organizatës për të cilën punojnë dhe nga klientelizmi ndërmjet eprorit dhe vartësit, etj.

SI MATET KORRUPSIONI?

Matja e nivelit të korrupsionit në vende të ndryshme mbetet gjithmonë një sfidë e vështirë pasi të dhënat empirike nuk mund të përdoren si matës të efektshëm të korrupsionit.

Transparency International (TI), e pranishme në më shumë se 100 vende, u krijua në vitin 1993 nga grup individësh të cilët vendosën të mbanin qëndrim kundër korrupsionit. TI punon për rritjen e ndërgjegjes kolektive për të sjellë ndryshimin e duhur në luftën lundër korrupsionit. Disa nga arritjet e shënuara si rezultat i punës dhe përpjekjeve të TI janë:

- Krijimi i konventave ndërkombëtare antikorrupsion
- Ndjekja penale e udhëheqësve të korruptuar dhe konfiskimi i përfitimeve të paligjshme të tyre



- Humbja e zgjedhjeve të fituara përmes korrupsionit
- Vënia përpara përgjegjësisë e kompanive përgjegjëse për sjelljen e tyre korruptive brenda dhe jashtë vendit.⁷

Në përpjekje për të matur korrupsionin, TI ka zhvilluar disa instrumente për matjen e korrupsionit si Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit (CPI) dhe Sistemi Kombëtar i Integritetit (NIS). CPI bazohet në opinionet e ekspertëve mbi korrupsionin në sektorin publik.

INDEKSI I PERCEPTIMIT TË KORRUPSIONIT 2014: REZULTATET PËR SHQIPËRINË

Më shumë se dy të tretat e 175 vendeve në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit 2014 shënojnë nën 50 pikë, në një shkallë nga 0 (perceptuar si shumë të korruptuara) në 100 (perceptuar si shumë të pastra). Danimarka qëndron në krye të klasifikimit për vitin 2014 me 92 pikë, ndërsa Korea e Veriut dhe Somalia qëndrojnë në vend të fundit, duke shënuar vetëm 8 pikë.

Shqipëria shënon 33 pikë në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2014, nga rezultati 31 pikë për vitin 2013. Këtë vit Shqipëria renditet në vendin e 110 nga 175 shtete të përfshira në indeks.

Shqipëria dhe Kosova renditen në të njëjtën rradhë me Ekuadorin, Etiopinë dhe Malavinë, duke shënuar performancën më të dobët në rajonin e Evropës Jug-Lindore. Ndërsa pikët më të larta në rajon i shënojnë Gjeorgjia, Maqedonia dhe Turqia.⁸

7 <https://www.transparency.org/whoweare/organisation/>

8 <http://tia.al/2014/12/03/tia-prezanton-indeksin-e-perceptimit-te-korrupsionit-cpi-2014/>



2


Elementët e Sistemit Kombëtar të Integritetit (NIS) në Shqipëri



Një tjetër instrument për matjen e korrupsionit i zhvilluar nga TI është Sistemi Kombëtar i Integritetit (NIS) i cili trajton rrënjët dhe simptomat e korrupsionit duke ndjekur një qasje sistemike.

Sistemi Kombëtar i Integritetit (NIS) përbëhet nga institucionet dhe aktorët kryesorë të cilët kontribuojnë për integritetin, transparencën dhe llogarëdhinen në një shoqëri të caktuar. Nivelet e ndryshme të qeverisjes janë elemente të sistemit të integritetit, sepse ato ekzistojnë për të plotësuar dhe kontrolluar njera-tjetrën në menaxhimin e pasurisë dhe trashëgimisë kombëtare. Çdo institucion në sistemin kombëtar të integritetit ka një rol të qartë e të dallueshëm në trajtimin e korrupsionit. Ky model ofron një vështrim gjithpërfshirës të institucioneve, politikave dhe praktikave të cilat, të gjitha së bashku, çojnë në parandalimin e korrupsionit në shoqëri.⁹

Figura 1: ‘Cikli i integritetit’ i TI¹⁰



9 http://archive.transparency.org/policy_research/nis#sthash.iZYUCeWj.dpuf

10 Centre for Business and Development Studies. Youth as Agents of Change in Anti-Corruption: A Cloak for a Neo-Liberal Agenda? 2011, p40.



ELEMENTËT E SISTEMIT KOMBËTAR TË INTEGRITETIT (NIS)

- **Legjislativi**
- **Ekzekutivi**
- **Gjyqësori**
- **Agjensitë e zbatimit të ligjit**
- **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve**
- **Avokati i Popullit**
- **Kontrolli i Lartë i Shtetit**
- **ILDKPKI**
- **Qeverisja Vendore**
- **Media**
- **Shoqëria civile**
- **Sektori privat**

LEGJISLATIVI

Kuvendi i Shqipërisë është organi më i lartë legjislativ i Shqipërisë. Kuvendi i Shqipërisë është një dhomësh dhe përbëhet nga 140 anëtarë të zgjedhur një herë në katër vjet me sistem proporcional me zona zgjedhore shumëmemërore.

Detyra kryesore e tij është të vendosë drejtimin politik të shtetit nëpërmjet shqyrtimit dhe miratimit të ligjeve (funksioni legjislativ). Përveç kësaj, Kuvendi gëzon një të drejtë kontrolli mbi organe dhe institucione të tjera kushtetuese apo të krijuara me ligj (funksioni kontrollues), duke i ndaluar në këtë mënyrë këto organe të ndërmarrin, në mënyrë të pavarur, vendime në kundërshtim me vullnetin popullor. Anëtarët e Kuvendit janë përgjegjës për zgjedhjen e Kryeministrit, kabinetit qeveritar dhe për miratimin e programit të Këshillit të Ministrave, (funksioni elektoral).



EKZEKUTIVI

Qeveria vepron si organi më i lartë i pushtetit ekzekutiv dhe formulon opsionet përmes të cilave përcaktohen qëllimet që shteti synon të ndjekë në një moment të caktuar historik nëpërmjet funksionit administrativ. Në Kushtetutën e Shqipërisë (neni 95, pika 2) përcaktohet se Këshilli i ministrave ushtron çdo funksion shtetëror i cili nuk u është dhënë organeve të pushteteve të tjera shtetërore ose të qeverisjes vendore.

Qeveria mban funksione normative, domethënë ajo mund të miratojë akte normative, të cilat kanë forcë më të ulët se ajo e ligjit; në disa raste mund të miratohen akte normative që kanë të njëjtën forcë si ligji pas delegimit prej parlamentit ose mbas ratifikimit prej tij.

Në mbështetje të këtyre funksioneve, qeveria shqiptare e ka vendosur luftën kundër korrupsionit në listën e përparësive më të rëndësishme të politikës së saj, gjë që pasqyrohet edhe në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit për vitet 2015-2020 dhe në Planin e Veprimit.¹¹

Në këtë kuadër është krijuar Koordinatori Kombëtar kundër Korrupsionit (KKK) i cili luan rolin e koordinimit, monitorimit dhe zbatimit të dokumenteve të politikave antikorrupsion. Gjithashtu, qeveria ka ndërmarrë hartimin e legjislacionit për mbrojtjen e bilbilfryrësve (whistleblowers). Ky ligj do të shërbejë për rritjen e transparencës së institucioneve publike dhe private, duke krijuar një mjedis më të mirë për punonjësit për të mënjanuar praktikat korruptive dhe për të rritur ndërgjegjësimin mbi raportimin e rasteve të korrupsionit. Aktualisht është vënë në dispozicion të qytetarëve edhe portal anti-korrupsion: www.stopkorrupsionit.al, ku mund të denoncohen rastet e korrupsionit në fusha të ndryshme.

GJYQËSORI

Pushteti gjyqësor ka këto funksione kryesore: Gjykimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe konflikteve që lindin ndërmjet palëve, ndërmjet individëve, ndërmjet institucioneve, etj. Sistemi Shqiptar i Drejtësisë përbëhet nga Gjykatat e Faktit, Gjykatat e Apelit dhe Gjykata e Lartë. Secili nivel i sistemit gjyqësor trajton çështje civile, çështje penale, çështje tregtare dhe çështje administrative.

11 http://www.ceshtjetvendore.gov.al/files/pages_files/15-04-01-05-52-47Strategjia_antikorrupsion_2015-2020_dhe_plani_i_veprimit.pdf



Gjyqësori është organi i cili ka për detyrë të gjykojë dhe të marrë vendime për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë edhe me praktikën korruptive.

Duke pasur parasysh përhapjen e korrupsionit dhe nivelin e lartë të pandëshkueshmërisë, gjyqësori mbetet thelbësor në suksesin e luftës kundër korrupsionit.

AGJENSITË E ZBATIMIT TË LIGJIT

Policia e shtetit

Policia e Shtetit Shqiptar është shërbimi policor i Republikës së Shqipërisë.

Misioni i Policisë është garantimi i një mjedisi të sigurtë për komunitetin nëpërmjet policimit me standartet më të larta të performancës, krijimit të një kulture bashkëkohore manaxhimi dhe të mbështetur me infrastrukturën më të përparuar si edhe krijimi i një mjedisi sa më të sigurt për shoqërinë shqiptare, i cili do të sjellë përmirësim në cilësinë e jetës së qytetarëve duke e bërë Shqipërinë një vend të dëshirueshëm për të punuar e jetuar.

Përgjegjësitë e Policisë janë si më poshtë:

- të mbrojnë jetën e njerëzve, sigurinë dhe pronën e tyre personale;
- të parandalojnë, të zbulojnë dhe të hetojnë, në përputhje me ligjin penal dhe me ligjin procedural penal, veprat penale dhe autorët e kryerjes së tyre, duke përfshirë praktikën korruptive që konsiderohen si vepra penale;
- të mbrojnë rendin dhe sigurinë publike;

Prokuroria e Përgjithshme

Prokuroria e Përgjithshme e Shqipërisë është një institucion kushtetues i pavarur. Ky institucion ushtron ndjekjen penale për të gjitha krimet, duke përfshirë edhe krimet e korrupsionit, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria i ushtron funksionet e veta duke respektuar parimet e procedimit të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor dhe mbrojtjes së të drejtave, interesave dhe lirive të ligjshme të njeriut. Prokuroria organizohet dhe funksionon nën drejtimin e Prokurorit të Përgjithshëm si strukturë e centralizuar, ku përfshihen zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, Këshilli i Prokurorisë dhe prokuroritë pranë sistemit gjyqësor.



INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

Synon të krijojë një dritare të rëndësishme për komunikimin më aktiv me zyrtarët e administratës publike dhe opinionin e gjerë, si edhe të realizojë transparencë maksimale për të gjitha proceset e hetimit administrativ të interesave private të zyrtarëve dhe për evidentimin e parandalimin e konfliktit të interesave.

- Deklarimi i interesave private: Nën përgjegjësinë e Inspektorit të Përgjithshëm, Inspektorati i Lartë administron deklarin e pasurisë, të detyrimeve financiare, ushtron kontroll të drejtpërdrejtë, mbledh të dhëna, kryen hetime dhe kërkime administrative rreth deklarimeve të personave që mbartin detyrimin ligjor për deklarin e interesave private. ILDKPKI bashkëpunon me organet e auditimit dhe me strukturat e tjera përgjegjëse për luftën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik.
- Parandalimi i konfliktit të interesave: Inspektorati i Lartë drejton dhe përmirëson politikat e parandalimit dhe shmangies së konfliktit të interesave; ofron asistencë teknike për këshillimin dhe mbështetjen e nismave ligjore e nënligjore të ndërmarra nga institucionet publike për parandalimin e konfliktit të interesave; monitoron, kontrollon dhe vlerëson zbatimin e këtij ligji etj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

KLSH ka për detyrë të kontrollojë:

- Veprimtarinë ekonomiko-financiare të institucioneve shtetërore e të personave të tjerë juridikë shtetërorë ;
- Përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve shtetërore nga organet e pushtetit qendror dhe vendor;
- Veprimtarinë ekonomike të personave juridikë, në të cilët shteti ka më shumë se gjysmën e pjesëve apo të aksioneve ose kur huatë, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti ;
- Përdorimin e fondeve që iu janë dhënë nga buxheti i shtetit partive politike dhe shoqatave.



AVOKATI I POPULLIT

Institucioni i Avokatit të Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj.

Ai ka si mision të tij parandalimin e konflikteve të mundshme midis administratës publike dhe individit. Avokati i Popullit vepron në bazë të ankesës apo kërkesës së paraqitur pranë tij.

Ai vepron edhe me nismën e vet, për raste të veçanta, të bëra publike, por gjithmonë duhet të marrë më vonë pëlqimin e të interesuarit ose të dëmtuarit.

Avokati i Popullit nuk vendos direkt vetë për t'ju dhënë të drejtat personit që ankohet, por bën rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi i administratës publike që sipas tij ka shkaktuar shkeljen e saj.

Në rastet kur organi përkatës nuk reagon ndaj rekomandimeve të Avokatit të Popullit, ky i fundit mund t'i drejtohet shkallë-shkallë organeve më të larta në hierarki, deri edhe Kuvendit (Parlamentit) me një raport, duke propozuar edhe masa konkrete për vënien në vend të së drejtës së shkelur.

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve është një organ i përhershëm që përgatit, mbikqyr, drejton dhe verifikon të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me zgjedhjet dhe me referendumet dhe shpall rezultatet e tyre. Në përputhje me Kodin Zgjedhor, KQZ ushtron kontrollin mbi financimet e fushatës zgjedhore ku nevojitet rritja e transparencës për të minimizuar hapësirat për praktika korruptive në financimin e partive politike.

QEVERISJA VENDORE

Qeverisja vendore nënkupton të drejtën e njerëzve në bashkësinë e caktuar territoriale që në mënyrë të pavarur të qeverisin punët e tyre, nëpërmjet organeve



të cilat i zgjedhin vetë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Parimi i decentralizimit të pushtetit është parim thelbësor mbi të cilin ngrihet dhe funksionon qeverisja vendore. Ai ushtrohet nëpërmjet parimit kushtetues të autonomisë vendore dhe kushtëzon ekzistencën e një pushteti vetëqeverisës vendor, sipas koncepteve të përparuara të organizimit të shtetit demokratik.

Në përputhje me Kartën Evropiane të Autonomisë lokale, me autonomi vendore kuptohet e drejta dhe aftësia efektive e bashkësive vendore për të rregulluar e për të drejtuar, brenda ligjit, nën përgjegjësinë e tyre dhe në të mirë të popullsisë të tyre, një pjese të mirë të çështjeve publike. Kjo e drejtë ushtrohet nga këshillat apo asambltetë e përbëra nga anëtarë të zgjedhur me votim të lirë, të fshehtë, të barabartë, të drejtpërdrejtë e universal dhe që mund të kenë organe ekzekutive përgjegjës para tyre.

MEDIA

Roli i medias në shoqëri është të informojë, të edukojë dhe të argëtojë publikun. Gjithsesi, shumë raste të praktikave korruptive në nivele të ndryshme do të mbeteshin të panjohura nëse nuk do të ishin bërë publike nga media përmes gazetarisë investigative. Megjithatë, duhet theksuar se informacioni i marrë nga media nuk mund të shërbejë si provë në një proces gjyqësor. Ky informacion duhet provuar në përputhje me kërkesat e ligjit.

ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE

Shoqëria civile përbëhet nga tërësia e organizatave dhe institucioneve sociale të formuara mbi bazë vullnetare dhe që përbëjnë bazën për një shoqëri funksionale përkundrejt strukturave shtetërore. Organizatat e shoqërisë civile (OSHC) mund të jenë Organizata Joqeveritare (OJQ), Shoqata Profesionale, Organizata në nivel komuniteti, etj. OSHC zakonisht veprojnë si mbikëqyrës (watchdogs) të qeverisë, veçanërisht në rastet kur ka mungesë veprimi ose përfshirje në praktika korruptive të zyrtarëve të lartë, të cilët duhet të veprojnë kundër korrupsionit. Gjithashtu, OSHC ofrojnë mbështetje të dobishme për qeverinë dhe parlamentin për hartimin dhe përmirësimin e ligjeve.



SEKTORI PRIVAT

Sektor privat mund të konsiderohet çdo kompani dhe institucion që nuk kontrollohet nga sektori publik dhe që ka qëllime përfitimi privat. Kemi të bëjme me korrupsion në sektorin privat atëherë kur grupe brenda këtij sektori ndikojnë në vendime dhe veprime të cilat çojnë në abuzim me pushtetin e besuar. Të gjitha organet e sektorit privat duhet të angazhohen në implementimin e programeve kundër ryshfetit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.



3

Përfshirja e të rinjve në luftën kundër korrupsionit



QASJET KUNDËR KORRUPSIONIT

Meqenëse shkaqet e korrupsionit përfshijnë faktorë të ndryshëm të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë, lufta kundër korrupsionit duhet të ketë një përqsasje gjithëpërfshirëse. Në këtë kontekst, korrupsioni mund të luftohet në rrugë të ndryshme, disa nga të cilat renditen me poshtë.

SHTYPJA OSE NDËSHKIMI

Njëra rrugë është të luftosh korrupsionin duke hetuar, duke arrestuar dhe duke ndëshkuar personat e përfshirë në të. Kjo kërkon rritjen e kompetencave hetimore të policisë dhe të prokurorisë, forcimin e mekanizmave të inspektimit, të kontrollit, etj. Kjo rrugë “shtypëse” mbështetet në idenë se korrupsioni është shkëmbim vullnetar i ndërmarrë nga pjesëmarrësit në të, për të realizuar interesat e tyre private. Ajo bazohet edhe në hamendësimin se ata që përgjigjen për kontrollin dhe zbatimin e ligjit (policia, prokuroria, etj.), nuk janë të korruptuar. Por asnjëri prej këtyre hamendësimeve, në vetvete, nuk është i vërtetë, veçanërisht në vendet dhe në institucionet ku korrupsioni është mjaft i përhapur ose mbizotërues.

PARANDALIMI

Rrugë më të ndërlikuara të përbaljes me korrupsionin janë ato që synojnë parandalimin e tij. Ato lidhen me ndërtimin dhe forcimin e institucioneve, të sistemeve dhe proçedurave të tilla që, nga njëra anë, të pakësojnë sa të jetë e mundur faktorët dhe stimujt që i shtyjnë njerëzit, që punojnë në to, të përfshihen në korrupsion dhe, nga ana tjetër, të rrisin sa më shumë stimujt që i shtyjnë njerëzit të largohen prej tij. E thënë shkurt, parandalimi i korrupsionit lidhet me qeverisjen e mirë.

Megjithatë, fakti i përmendur më sipër, që njerëzit përfshihen në korrupsion të detyruar nga pushtete të caktuara ose nga kultura e favoreve (e ndereve) të ndërsjella, të çon në idenë se qeverisje e mirë nuk do të thotë, thjesht dhe vetëm, të ndërtohet institucione që synojnë të ndihmojnë njerëzit të shmangin korrupsionin



për shkak të interesit të tyre privat. Qeverisja e mirë nënkupton ndërtimin e institucioneve, për të cilat njerëzit që punojnë të ndihen krenarë dhe në të cilat marrja me korrupsion të vlerësohet si diçka e huaj për konceptin e rolit të tyre publik, si shërbëtorë të popullit.

Një faktor i rëndësishëm i strategjive parandaluese është kundërshtimi, gjithnjë e më i qëndrueshëm, ndaj korrupsionit prej qytetarëve si përdorues të shërbimeve publike. Kjo kërkon që qytetarëve t'u sigurohet mundësia të njohin, jo vetëm të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, por edhe pasojat që sjell korrupsioni për shoqërinë dhe për ata si individë. Një gjë e tillë do të mund të ishte më e efektshme, nëse do të ishte pjesë e një politike më të gjerë, që krahas synimit për krijimin e një qytetarie të mirë, do të kishte si objektiv, veçanërisht në fushën e arsimit, që nxënësit të dalin nga shkolla me bindjen se kundërshtimi i korrupsionit shkon përtej interesit të tyre vetjak dhe bazohet në pikëpamjen e përbashkët për tiparet e kësaj lloji qytetarie.

NDËRGJEGJËSIMI OSE EDUKIMI

Shkolla mund të luajë një rol themelor në kuadër të politikave kundër korrupsionit. Nga ajo kërkohet të ndihmojë brezat e rinj, nxënësit dhe studentët, për t'u bërë të aftë të përballojnë, me vullnet dhe sukses, trysnitë që i shtynë ata në pranimin e ryshfeteve, duke u përfshirë në praktika korruptive.

Njohja me të drejtat dhe interesat e tyre, i pajis nxënësit me aftësinë dhe pushtetin për të përballuar trysninë e dhënies dhe marrjes së ryshfeteve, edhe nëse kjo gjë, në pamje të parë duket në interes të tyre. Po kështu, ideja se qytetarët i kanë këto njohuri, i frenon zyrtarët të kërkojnë ryshfete.

Më tej, nëse qytetarët (dhe zyrtarët), si rrjedhojë e arsimit të tyre, janë mësuar të vlerësojnë ryshfetin dhe praktika të ngjashme si të papajtueshme me rolin e tyre publik si qytetarë ose zyrtarë, ata kthehen në pengesa të pakapërcyeshme kundër korrupsionit.

Edukimi kundër korrupsionit mund të luajë një rol vendimtar edhe në përpjekjet për të ulur shpeshtësinë e kësaj dukurie tejet dëmtoese për shoqërinë shqiptare.



FORMAT E VEPRIMTARIVE NDËRGJEGJËSUESE

Më poshtë janë disa shembuj nga veprimtaritë ndërgjegësuese që mund të ndërmerren nga nxënësit:

- Përdormi i medias për të rritur shkallën e ndërgjegjësimit (blogjet, emisionet radiofonike, intervistat në TV, grupet në Facebook, YouTube, Twitter)
- Konkurse ndërmjet nxënësve për të nxitur qëndrimet antikorrupsion (tematikat: filma të shkurtër, ese, foto, vizatime, drama)
- Konkurse për grante të vogla
- Seminare, workshope, leksione, diskutime në tryeza të rumbullakta, dhe forma të tjera trainimi
- Grumbullimet (grumbullime për një kohë të shkurtër por me vizibilitet të lartë që organizohen online dhe tërheqin vëmendjen për një çështje të caktuar pa shkaktuar trazira dhe pa prishur rendin publik)
- Shpërndarja e materialeve antikorrupsion (fletëpalosje, stickers, t-shirts)
- Veprimtari në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Antikorrupsionit (9 Dhjetor), etj.



UDHËZUES PËR ORGANIZIMIN DHE ZBATIMIN E VEPRIMTARIVE

»»» GRUMBULLONI NJERËZIT

Krijoni një ekip njerëzish që do të punojnë për veprimtarinë që do të organizoni. Delegoni përgjegjësi. Për shembull: një anëtar me aftësi krijuese mund të përgjigjet për hartimin e materialeve publicitare dhe njëtjetër anëtar me aftësi të mira organizative mund të merret me organizimin dhe komunikimin.

»»» KRIJONI RREGULLAT E LOJËS

Krijoni rregullat bazë për veprimtarinë përkatëse. Për shembull: Kush do të marrë pjesë? Si do të rekrutohen apo përzgjidhen pjesëmarrësit? Nëse bëhet fjalë për konkurs: Si do të përzgjidhen fituesit? Cilat janë kriteret e përzgjedhjes? Kush do të shqyrtojë materialet e dorëzuara dhe mbi cilat kriteret? Cili do të jetë çmimi/motivimi për pjesëmarrjen në këtë veprimtari?

»»» MENDONI NJË PARRULLË

Të jetë e shkurtër dhe e thjeshtë por provokuese dhe e përshtatshme për profilin e target grupit tuaj. Kjo parrullë do të shërbejë si logoja e veprimtarisë ndërgjegjësuese.

»»» PRODHONI MATERIALE PROMOCIONALE

Printoni postera, fletushka, dhe materiale të tjera promociionale. Vendosini ato në vende strategjike — bibliotekë, lokale, qendra kulturore apo vende të tjera ku zakonisht mbliidhen nxënësit.



»» **PUBLIKONI ONLINE**

Përdorni rrjetet sociale dhe Internetin për të promovuar veprimtarinë tuaj. Krijoni një grup në Facebook dhe postoni kujetsa për të mbajtur gjërat në lëvizje deri në përfundim të veprimtarisë. Publikojeni në postale apo formate popullore në web. Nëse synoni të arrini një target grup të caktuar, gjeni komunitetin apo forumin e tyre online dhe postojeni aty.

»» **PËRDORNI MDEIAT KRYESORE**

Shkruani një komunikatë për shtyp dhe dërgojani medias dhe gazetarëve. Përpiquni të nxisni interesimin për veprimtarinë tuaj.

»» **TAKOHUNI RREGULLISHT**

Caktoni vendin dhe oraret e takimeve. Organizoni mbledhje të ekipit të projektit për të diskutuar për sukseset dhe sfidat.

»» **FESTONI**

Organizoni një ceremoni hapëse ose mbyllëse për të festuar veprimtarinë dhe për të përgëzuar pjesëmarrësit. Kjo gjë mund të rrisë vëmendjen e medias për veprimtarinë tuaj dhe të shërbejë si mundësi për të promovuar mesazhin kryesor të organizatës.

»» **BËNI SA MË TË DUKSHËM PRODUKTET PËRFUNDIMTARE TË VEPRIMTARISË**

Për shembull, Vendosni online videot dhe fotot e veprimtarisë.





Burime të
Dobishme
Informacioni

Project Against Corruption in Albania (PACA): Edukimi kundër korrupsionit: Manual për mësuesit.

<https://www.coe.int/t/dghl/cooperation/economiccrime/corruption/Projects/Albania/Manuals/Edukimikunderkorrupsionit-finalversion20feb2012.pdf>

Portali anti-korrupsionit: <http://www.stopkorrupsionit.al/>

Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit për Periudhën 2015-2020

Transparency International Anti-Corruption Kit: 15 ideas for young activists: http://www.transparency.org/whatwedo/publication/anti_corruption_kit_15_ideas_for_young_activists

Transparency International: <https://www.transparency.org/>

United Nations Global Programme against Corruption (GPAC), 'Anti-Corruption Tool Kit', 2002. <http://www.unodc.org/pdf/crime/toolkit/f1tof7.pdf>

USAID: Addressing corruption in Education – A toolkit from youth for youth. http://idd.edc.org/sites/idd.edc.org/files/Transparency%20in%20Education_Tool%20Kit_EDC%20reduced.pdf



Referenca



Centre for Business and Development Studies, 'Youth as Agents of Change in Anti-Corruption: A Cloak for a Neo-Liberal Agenda?', 2011. Marrë nga adresa: http://studenttheses.cbs.dk/bitstream/handle/10417/2011/stinne_hjulmann_og_stine_vejborg_andersen.pdf?sequence=1

Project against Corruption in Albania (PACA), 'Edukimi kundër korrupsionit: Manual për mësuesit', 2012. Marrë nga adresa: <https://www.coe.int/t/dghl/cooperation/economiccrime/corruption/Projects/Albania/Manuals/Edukimikunderkorrupsionit-finalversion20feb2012.pdf>

Strategjia Ndërsektorale Kundër Korrupsionit për Periudhën 2015-2020. Marrë nga adresa: http://www.ceshtjetvendore.gov.al/files/pages_files/15-04-01-05-52-47Strategjia_antikorrupsion_2015-2020_dhe_plani_i_veprimit.pdf

Transparency International Albania: <http://tia.al>

Transparency International: <https://www.transparency.org/>

United Nations Convention against Corruption, 31 October 2003. Marrë nga adresa: <http://daccess-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N03/453/15/PDF/N0345315.pdf?OpenElement>

USAID, 'Addressing corruption in Education – A toolkit from youth for youth', 2012. Marrë nga adresa: http://idd.edc.org/sites/idd.edc.org/files/Transparency%20in%20Education_Tool%20Kit_EDC%20reduced.pdf



